



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 592 / Prot.
1

Tiranë, më 10.04.2017

VENDIM

Nr. 60, datë 10/4/2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) “Formularin e Ankesës nr. 592 Prot., datë 29.03.2017, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës dërguar me postë elektronike në adresën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me nr. rendor 19, datë 27.02.2017, ka kërkuar informacion në lidhje me:

1. Numrin e të punësuarve në Klan, Vizion Plus, Top Channel, Digitalb, Tring Tv, Ora News, Report Tv, TVSH;
2. Nr. e të siguruarve me pagë minimale 22.000 lekë;
3. Nivelin e pagës maksimale dhe numrin e të siguruarve mbi këtë page;
4. Kur ka qenë hera e fundit kur është ushtruar kontroll në subjektet e sipërpërmendura, me objekt kontrollin e personave të siguruar dhe sa kontrolle tatimore me objekte të ndryshme, janë kryer në mediat e mësipërme;
5. Cili ka qenë rezultati i këtyre kontrolleve (sipas raporteve të hartuara).

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Komisionerit.

Në përgjigjen e dërguar me email-in e datës 20.03.2017, Autoriteti Publik ka argumentuar se informacioni nuk mund të vendoset në dispozicion të kërkuarit për shkak se subjektet e

legjitime në kërkimin e këtij informacioni janë vetëm ato të parashikuara në nenin 24 dhe 25 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Autoriteti Publik referon në refuzimin e dhënies së informacionit në nenin 24 dhe 25 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke legjitimuar për akses në informacionin e disponuar nga autoritetet tatimore vetëm institucionet e përmendura në këtë dispozitë dhe duke përjashtuar *a priori* çdo individ që kërkon akses sipas dispozitave të Ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (në vijim quajtur “Ligji për të Drejtën e Informimit”).

Sqarojmë se dispozitat e cituara nga Autoriteti Publik janë të zbatueshme vetëm për ato raste kur informacioni nuk përbën informacion publik dhe dhënia e tij kryhet në një kontekst të caktuar siç është rasti i një procesi gjyqësor civil apo penal, kontrolli i ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në kuadër të veprimtarisë së tij etj.

Ligji për të Drejtën e Informimit rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Gjithashtu ky ligj, në nenin 17 të tij përcakton edhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Nuk rezulton që në përgjigjen e kthyer, Autoriteti Publik të ketë argumentuar refuzimin e kërkesës në përputhje me këtë nen.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe konsultimi i legjislacionit, rezulton se kemi të bëjmë me informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2 të Ligjit për të Drejtën e Informimit ku *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*.

Bazuar në nenin 18, pika 2 a) e Ligjit për të Drejtën e Informimit, refuzimi i dhënies së informacionit publik përbën shkelje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150 000 deri në 300 000 lekë.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankimin e Z. _____, kundër Autoritetit Publik/ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit të Z. _____, nr. 592 datë 29.03.2017 kundër Autoritetit Publik "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve" për vënien në dispozicion të informacionit sipas kërkesës për informim.
3. Dënimin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve", Znj. _____, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
6. Ky vendim u dha sot në datë 10. 4 .2017.

